



Komisioni Europian

Kuptimi i Zgjerimit

Politika e Unionit Europian për Zgjerim







*Oli Ren
Anëtar i Komisionit Europian
përgjegjës për zgjerim*

Në periudhën e gjatë gjysmë shekulli, Unioni European ka ushtruar integrimin më të thellë se ndonjëherë më parë, me pranimin e anëtarëve të rinj. Pothuajse tërë kohën, dy proceset u zhvilluan paralelisht. Si rrjedhojë e kësaj, Unioni i sotëm European me 27 shtete anëtare dhe popullatë prej rreth 500 milionë njerëz, është më i sigurtë, më i begatë, më i fuqishëm dhe me ndikim më të madh se Bashkësia e hershme Ekonomike Europiane i para 50 viteve, me 6 anëtarë dhe popullatë prej më pak se 200 milionë.

Anëtarësimi që shtohet dita ditës, ka qënë pjesë e zhvillimit të integritimit europian, që nga fillimi. Debati mbi zgjerimin është po aq i vjetër sa edhe vet UE-ja. Gjatë çdo pranimi të anëtarëve të rinj, UE-ja ndryshon. Duke menduar se çka do të ndodhë me ne, na detyron të mendojmë se çka jemi tani dhe çka do të mbetemi në të ardhmen.

Zgjerimet e vitit 2004 dhe 2007, me vendet nga Europa Qendrore, Lindore dhe Mesdheu kanë treguar arritje të madhe të UE-së. Megjithatë, ato janë konsideruar si faktore për të gjitha problemet e mundshme sociale dhe ekonomike në Europë. Në të vërtetë, cikli i fundit i zgjerimit ka zhvilluar sferën e paqes, stabilitetit dhe demokracisë në kontinentin tonë,

dhe ka përfurcuar ekonominë e Europës me zgjerimin e tregjeve, krijimin e mundësive të reja afariste dhe inkuadrimit të ekonomive të zhvilluara në tregun unik. Tani, UE-ja është zona më e madhe ekonomike në botë. Tregu më i gjerë ndërkombëtar dhe mundësitë e reja ekonomike, kanë forcur mirëqenien dhe konkurrencën e europianëve.

Qeveritë e shteteve anëtare të UE-së, të zgjedhura në mënyrë demokratike, përfaqësuesit e të cilave tubohen në Këshillin European, kanë rënë dakord që zgjerimet e ardhshme të përfshijnë vendet, të cilat tashmë punojnë në drejtim të anëtarësimit në UE - Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia bashkë me Kosovën (nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244) dhe Turqia. Anëtarësimi do të realizohet atëherë kur secili nga këto vende do të plotësojë kërkesat e domosdoshme. Procesi i zgjerimit i menaxhuar gradualisht dhe me kujdes, krijon një situatë, në të cilën të gjitha vendet në fjalë përfitojnë.

Qëllimi i kësaj broshure është të shtjellojë në mënyrë të qartë dhe koncize domethënien dhe implementimin e politikës së UE-së për zgjerim. Me anë të broshurës, është bërë përpjekje që lexuesi të fitojë një pasqyrë mbi zhvillimin e UE-së qysh nga krijimi, pozitën e sotme të UE-së pas ciklit më të rëndësishëm të zgjerimit të vet në vitin 2004 dhe 2007, si dhe të kuptojë se cila është perspektiva e pranimi të anëtarëve të rinj në të ardhmen. Mbi të gjitha, ky botim është i menduar për t'u përgjigjur pyetjeve të shpeshta si për shembull: "Kush vendos?" dhe "Si bëhet Shtet Anëtar një vend aspirues?"

Uroj që leximi i kësaj broshure të jetë informues dhe i lehtë, i cili do t'u përgjigjet pyetjeve tuaja mbi zgjerimin e UE-së.

Oli Ren



Komisioni Europian dhe personat që veprojnë në emër të Komisionit nuk mbajnë përgjegjësinë për përdorimin e mundshëm të informatave në vijim.

Shumë informata plotësuese mbi Unionin Europian janë në dispozicion në Internet dhe mund të qasen përmes serverit Europa (<http://europa.eu/>)

Informatat mbi zgjerimin e Unionit Europian mund t'i gjeni në faqen e Drejtorisë Gjenerale për Zgjerim (<http://ec.europa.eu/enlargement/>).

Të dhënat e katalogizimit mund t'i gjeni në fund të këtij botimi.

ISBN 978-92-79-06636-8

Komisioni Europian, Drejtoria Gjenerale për Zgjerim, 2007

© Komunitetet Europiane 2007

Reprodukimi është i autorizuar me kusht që burimi i botimit të jetë i pranuar.

Botuar në Belgjikë

Nga 6 në 27 Shtete Anëtare	4
Kush mund të anëtarësohet?	6
Kush vendos?	8
Procesi i zgjerimit në vepër: plotësimi i kërkesave	9
Ndihma për kandidatët që përgatiten për anëtarësim	14
E ardhmja	16



Nga 6 në 27 Shtete Anëtare

Më 25 mars 1957, kryetarët e gjashtë vendeve që akoma po mirrin veten nga rrënimet e luftës, u takuan bashkë në Romë për të nënshkruar zyrtarisht Traktatet që përfundimisht sollën krijimin e asaj që sot e quajmë Union European. Ishte një lëvizje e padëgjuar, e cila kërkonte shumë guxim dhe vizion – vendet të cilat kishin luftuar me shekuj kundër njëri tjetrit ranë dakord të marrin vendime të përbashkëta mbi çështjet vitale për ardhmërinë e tyre. Ata u pajtuan të transferojnë një pjesë të fuqisë së tyre në një shkallë të re, të cilës thjesht i referohemi si Unioni European.

UE-ja ka qënë arritje historike, e cila ka mundësuar përiudhën më të gjatë të pashkëputur të paqes dhe një nivel të pakrahasueshëm të prosperitetit për popujt e vet. Ajo që filloi si një klub 6 anëtarësh, tani është vatër e 27 vendeve me popullatë rreth 500 milionë banorë. Ky sukses e ka shndërruar atë në magnet. Integrimi i anëtarëve të rinj ishte pjesë e planit që nga zanafilla. Themeluesit me besim në vete lanë derën hapur për anëtarësimin e vendeve të tjera të Europës. Ndihma për vendet që kanë prirje për anëtarësim, ka qënë përgjigja e UE-së ndaj ndryshimeve në tablonë politike të Europës gjatë pesë dekadave të kaluara, duke përkrahur zhvillimin ekonomik dhe solidaritetin dhe duke i përforcuar fuqitë demokratike në vendet që dilnin nga diktatura.



Unioni Europian ka mundësuar përfitimë të mëdha për të gjithë europianët – stabilitetin, prosperitetin, demokracinë, të drejtat e njeriut, liritë fundamentale dhe ushtrimin e ligjit. Këto nuk janë parime të paqarta por janë metoda që kanë transformuar kualitetin e jetës të miliona njerëzve. Dobitë nga tregu i vetëm për konsumatorët në UE janë evidente: zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës, prodhime më të sigurt, çmime të ulta dhe alternativa të ndryshme në sektorët vendimtarë. Disa nga këta sektorë janë telekomunikimet, veprimet bankare dhe transporti ajror.

Por, UE-ja nuk nënkupton vetëm pasurinë dhe standartet e përmirësuar jetësore. Shumë qytetarë të UE-së akoma kujtojnë fëmijërinë e tyre gjatë luftës ose nën regjimet represive dhe me frikën nga policia sekrete. Shumë europianë kanë në kujtesë druajtjet dhe persekutimet e të kaluarës. Shumë nga ata u rritën jashtë vendlindjeve të tyre – fëmijët e dëbuar politikisht. UE-ja është një bashkësi vlerash. Ne jemi një familje e përbërë nga vendet demokratike të Europës, që janë angazhuar të punojnë së bashku për paqen dhe prosperitetin, lirinë dhe drejtësinë sociale. Dhe ne i mbrojmë këto vlera. Përpiqemi që të kultivojmë bashkëpunimin midis popujve të Europës, duke respektuar dhe ruajtur lirinë tonë.

Zgjerimet pasuese

Organizata e themeluar në vitin 1957, e quajtur Bashkësitë Europiane, e cila tani njihet si Unioni Europian, fillimisht kishte gjashtë anëtarë: Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda.



Në vitin 1973, u anëtarësuan Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe. Greqia u anëtarësua në vitin 1981, kurse Portugalia dhe Spanja pasuan në vitin 1986. Austria, Finlanda dhe Suedia u anëtarësuan në vitin 1995.



Në vitin 2004, gjatë zgjerimit më të madh të UE-së, Shtete Anëtare u bënë Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.



Në janar të vitit 2007, u anëtarësuan Bullgaria dhe Rumania dhe numri i anëtarëve të UE-së u rrit në 27.



Kush mund të anëtarësohet?

Kërkesat e anëtarësimit në UE janë përcaktuar me përpikëri të theksuar gjatë tërë evolucionit të UE-së, në mënyrë që të ofrojnë qartësi për qytetarët e vet dhe drejtime për vendet që duan të anëtarësohen.

Neni 49 i Traktatit mbi Unionin Europian thekson se të gjitha vendet e Europës mund të bëjnë kërkesë për anëtarësim, nëse i respektojnë parimet e lirisë, demokracisë, të drejtat e njeriut, liritë fundamentale dhe sundimin e ligjit.

Një vend mund të anëtarësohet vetëm nëse plotëson kriteret e anëtarësimit, të definuara nga Këshilli Europian në Kopenhagë në vitin 1993, dhe të zbatuara në vitin 1995. Këto kriterë janë:

Neni 6 (1) i Traktatit të Unionit Europian

“Unioni themelohet në parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirisë fundamentale dhe sundimit të ligjit. Të gjitha këto parime janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare”

Neni 49 i Traktatit të Unionit Europian

“Secili shtet në Europë, i cili respekton parimet e përcaktuara në nenin 6(1) mund bëjë kërkesë për t’u anëtarësuar në Union.”

1. *Kriteri politik:* institucione stabile që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.

2. *Kriteri ekonomik:* ekonomi funksionale e tregut dhe kapaciteti për të përballuar konkurrencën dhe fuqitë e tregut në UE.

3. *Kapaciteti i pranimit të obligimeve të anëtarësimit,* përfshirë këtu edhe mbështetjen e synimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar.

4. *Miratimi i një organizmi të tërë legjislativ europian* dhe implementimi i efektshëm i këtij legjislacioni me anë të strukturave të duhura administrative dhe juridike.

Veç kësaj, UE-ja duhet të jetë kompetente të integrojë anëtarë të rinj, prandaj mban të drejtën e vendosjes së periudhës së pranimit të tyre.

Disa vende të Europës akoma nuk e kanë kthyer perspektivën e tyre europiane në anëtarësim në UE. Kroacia, Turqia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë tashmë janë candidate, me atë që Kroacia dhe Turqia kanë filluar negociatat drejt anëtarësimit. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor – Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, midis tyre edhe Kosova (nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244) – gjithashtu janë duke punuar në drejtim të plotësimit të kërkesave për të ecur përpara. Shpejtësia me të cilën avancojnë çdo vend në veçanti, varet vetëm nga progresi i vendit drejt synimeve tona të përbashkëta.



Ku jemi?

UE-ja ka njohur Turqinë dhe Kroacinë si vende kandidatë. Negociatat e anëtarësimit me të dyja vendet filluan më 3 tetor 2005.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë u pranua si vend kandidat në dhjetor të vitit 2005.

Në vitin 2003, krerët e shteteve dhe qeverive të UE-së miratuan "Axhendën e Selanikut" me të cilën u konfirmuan perspektivën e anëtarësimit të ardhshëm për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Si pasojë, Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244), konsiderohen si shtete potenciale kandidatë.



Vendet kandidatë

- 1 Kroacia
- 2 Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
- 3 Turqia

Vendet potenciale kandidatë

- 4 Shqipëria
- 5 Mali i Zi
- 6 Bosnje e Hercegovina
- 7 Serbia
- 8 Kosova (nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së)

Kush vendos?

Anëtarët e rinj pranohen vetëm nëse janë të përgatitur dhe vetëm me pëlqimin e njëzëshëm të qeverive demokratike të shteteve anëtare të UE-së, të cilat takohen në Këshillin e Ministrave ose në Këshillin Europian. Kjo vlen për të gjitha fazat e procesit.

Shumë kohë para fillimit të negociatave, të gjitha marrëveshjet midis UE-së dhe shteteve jashtë UE-së, siç janë Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asocimit me vendet e Ballkanit Perëndimor ose Unioni Doganor me Turqinë, arrihen vetëm pasi që Shtetet Anëtare të UE-së të kenë dhënë pëlqimin e tyre.

Kur një vend bën kërkesë për anëtarësim në UE, qeveritë e Shteteve Anëtare të prezantuara në Këshill, vendosin – pas marrjes së opinionit nga Komisioni – nëse duhet të pranojnë kërkesën dhe të njohin vendin si kandidat. Në mënyrë të ngjashme, vendosin vet Shtetet Anëtare kur dhe me cilat kushte të hapin dhe

të mbyllin negociatat e anëtarësimit me vendet candidate, mbi politikatat në veçanti (që ndryshe janë emëruar “kapitulli”, shiko “Procesi i zgjerimit në vepër” më poshtë). Dhe Shtetet Anëtare janë ato që vendosin kohën kur negociatat e anëtarësimit janë përfunduar në nivel të kënaqshëm.

Propozim Traktatin e Anëtarësimit duhet ta miratojë dhe ta nënshkruajë çdo Shtet Anëtar para periudhës kur vendi kandidat bëhet shtet i anëtarësuar. Pas kësaj, Traktatin duhet ta ratifikojnë të gjitha Shtetet Anëtare, në pajtim me procedurat e tyre të themelura me kushtetutë. Pëlqimin e vet duhet ta japë edhe Parlamenti Europian, anëtarët e të cilit zgjidhen drejtpërsëdrejti nga qytetarët e UE-së.



Procesi i zgjerimit në vepër: plotësimi i kërkesave

Politika e UE-së për zgjerim siguron procesin e menaxhuar të anëtarësimit, kështu që nga zgjerimi përfitojnë njëkohësisht edhe UE-ja edhe vendet që anëtarësohen. Kandidatët duhet të demonstrojnë zotësinë e tyre për të luajtur rolin e tyre të plotë si anëtarë – diçka që kërkon përkrahje të gjerë nga qytetarët e tyre, si dhe përputhshmëri politike dhe teknike me standardet dhe normat e UE-së. Gjatë procesit, nga kërkesa deri në anëtarësim, UE-ja zbaton procedura graduale dhe gjithpërfshirëse të miratimit.

Një vend që dëshiron të anëtarësohet në UE, dorëzon kërkesën për anëtarësim në Këshill, ku janë të përfaqësuara qeveritë e të gjitha Shteteve Anëtare të UE-së. Këshilli kërkon nga Komisioni të vlerësojë kompetencat e kërkuesit për të plotësuar kushtet e anëtarësimit. Nëse Komisioni dorëzon opinion pozitiv dhe Këshilli bie dakord njëzëshëm për mandatin e bisedimeve, negociatat hapen zyrtarisht mes kandidatit dhe të gjitha Shteteve Anëtare.

Për të ndihmuar vendet që përgatiten për anëtarësim në të ardhmen, është hartuar një strategji para-anëtarësuese. Elementet kyç të kësaj strategjie përfshijnë marrëveshjet që përcaktojnë të drejtat dhe obligimet (siç janë Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asocimit në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor), si dhe mekanizmat e veçantë të bashkëpunimit si Partneritetet Anëtarësuese ose Europiane, të cilat përcaktojnë objektiva konkrete për reformat që duhet të realizohen nga vendet candidate dhe nga kandidatet potenciale. Ndihma financiare e UE-së është edhe një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjive para-anëtarësuese.

Negociatat e anëtarësimit

Së pari, është me rëndësi të theksohet se shprehja “negociata” mund të jetë çorëntuese. Negociatat e anëtarësimit përqëndrohen në kushtet dhe fazën e miratimit, implementimit dhe zbatimit të rregullave të UE-së nga vendet candidate – rreth 90,000 faqe. Dhe këto rregulla (të njohura me termin “acquis”, fjala frenge që do të thotë “ajo që është dakorduar”) nuk janë të negociueshme. Për kandidatët, para së gjithash, është çështje e dakordimit të mënyrës dhe kohës së miratimit dhe implementimit të rregullave dhe procedurave të UE-së. Për Unionin, është me rëndësi të marrë premtimin lidhur me datën dhe efektshmërinë e implementimit të rregullave nga çdo vend kandidat në veçanti.

Negociatat administrohen individualisht me shtetet candidate, kurse ritmi i bisedimeve varet nga progresi i vendeve në plotësimin e kërkesave. Në këtë mënyrë, vendet candidate janë të stimuluar të implementojnë reformat e domosdoshme me shpejtësi dhe në mënyrë të efektshme. Disa nga këto reforma kërkojnë transformime mjaft të mëdha e nganjëherë edhe të vështira të strukturave politike dhe ekonomike të vendit. Prandaj, është me rëndësi që qeveritë të kumtojnë arsyet e këtyre reformave, në mënyrë të shkoqur dhe bindëse për qytetarët e vendit të tyre. Përkrahja e shoqërisë civile është thelbësore në këtë proces.

Negociatat e anëtarësimit realizohen mes Shteteve Anëtare dhe vendeve candidate. Seancat negociuese mbahen në nivel të ministrave dhe zëvendësve, d.m.th. Përfaqësuesit Permanentë të Shteteve Anëtare dhe Ambasadorët ose Negociatorët Prijës të vendeve candidate.

Për të lehtësuar negociatat, i tërë organizmi ligjor i UE-së është i ndarë në “kapituj” dhe secili kapitull korrespondon me nga një politikë. Hapi i parë i negociatave quhet “ekzaminim”; qëllimi i të cilit është të identifikojë sferat që kanë nevojë harmonizimin e legjisllacionit, institucioneve, përvojave të vendit kandidat.

Kapitujt e Acquis-së

1. Lëvizja e lirë e mallërave
2. Liria e lëvizjes për punonjësit
3. E drejta e vendosjes dhe lirisë për sigurimin e shërbimeve
4. Lëvizja e lirë e kapitalit
5. Furnizimi publik
6. E drejta e ndërmarrjeve
7. E drejta e pronësisë intelektuale
8. Politika e konkurrencës
9. Shërbimet financiare
10. Shoqëria informative dhe mediat
11. Bujqësia
12. Siguria e ushqimit, veterinaria dhe politika fitosanitare
13. Peshkataria
14. Politika e transportit
15. Energjia
16. Tatimet
17. Politika ekonomike dhe monetare
18. Statistika
19. Politika sociale dhe punësimi
20. Politika sipërmarrëse dhe industriale
21. Rrjetet tej-Europiane
22. Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore
23. Të drejtat ligjore dhe fundamentale
24. Drejtësia, liria dhe siguria
25. Shkenca dhe hulumtimi
26. Arsimi dhe kultura
27. Mjedisi
28. Mbrojtja e konsumatorëve dhe e shëndetit
29. Unioni doganor
30. Marrëdhëniet e jashtme
31. Politika e jashtme, sigurisë, mbrojtjes
32. Kontrolli financiar
33. Dispozitat financiare dhe buxhetore
34. Institucionet
35. Çështje të tjera

Si bazë për fillimin e procesit ekzistues teknik të negociatave, Komisioni formon një "raport ekzaminues" për çdo kapitull dhe për çdo vend. Këto raporte i dorëzohen Këshillit. Komisioni është ai që duhet të rekomandojë fillimin e negociatave për një kapitull ose të kërkojë që në radhë të parë të plotësohen kushtet e caktuara (ose të ashtuquajturat "etapa").

Vendi kandidat atëherë dorëzon pozitën negociuese. Në bazë të propozimit të Komisionit, Këshilli miraton pozitën e përbashkët të UE-së, duke lejuar fillimin e negociatave.

Pasi që UE-ja të ketë harmonizuar pozitën e përbashkët mbi çdo kapitull të *acquis-së*, dhe pasi që kandidati të ketë pranuar pozitën e përbashkët të UE-së, negociatat mbi atë kapitull mbyllen – por vetëm përkohësisht. Negociatat për anëtarësim në UE funksionojnë në parimin "asgjë nuk është e harmonizuar nëse gjithçka nuk është dakorduar", prandaj mbyllja definitive e kapitujve ndodh në fund të procesit të përgjithshëm të negociatave

Raporti Ekzaminues për Kroacinë, Kapitulli 20 – Politika sipërmarrëse dhe industriale

"III.Vlerësimi i shkallës së harmonizimit dhe kapacitetit implementues

*Në përgjithësi, Kroacia ka arritur një nivel të kënaqshëm të harmonizimit me *acquis*-në; ajo që mbetet është të finalizojë strategjinë e vet industriale, të shtojë kapacitetet e veta të vlerësimit të konkurrencës industriale dhe të përmirësojë analizën dhe formulimin e politikës [...]."*



Raportimi dhe mbikqyrja

Komisioni informon me kohë Këshillin dhe Parlamentin European lidhur me progresin e vendeve candidate, me anë të kumtesave të strategjisë vjetore dhe raporteve mbi progresin individual të vendeve. Komisioni gjithashtu mbikqyr plotësimin e kërkesave të përcaktuara dhe progresin e respektimit të premtimeve.



Raporti i Progresit 2006 për Turqinë, Kapitulli 25, "Shkenca dhe Hulumtimi"

"Politika hulumtuese e Turqisë rezultoi me buxhet dukshëm të zmadhuar për hulumtim dhe zhvillim: thuajse pesëfish në krahasim me shkallën e vitit 2002. Universitete të reja janë hapur në 15 qytete. Janë shënuar përmirësime edhe në kapacitetet shkenore dhe hulumtuese të Turqisë, duke përfshirë pjesëmarrjen më të suksesshme në FP6 [Programi i 6-të Kornizë]. Ritmi i suksesit të Turqisë në suaza të FP6 është përmirësuar dhe tani ka arritur në 17% por kjo përqindje është nën mesataren 20% në aspektin financiar. Turqia ishte kryesisht e suksesshme në sigurimin e projekteve të vogla. Mirëpo, financimi i UE-së nuk ka arritur potencialin e vet.

Duke marrë parasysh aktivitetet e Turqisë lidhur me lëvizshmërinë e hulumtuesve, shkencën dhe shoqërinë, si dhe PBN prej 3% për masat e Planit të Veprimit mbi Shkencën dhe Teknologjinë, Turqia tashmë është e integruar mirë në Sferën Hulumtuese Europiane."

Mbikqyrja vazhdon deri në momentin e anëtarësimit. Kjo mundëson dhënien e udhëzimeve plotësuese pas marrjes së përgjegjësive të anëtarësisë dhe gjithashu u garanton Shteteve Anëtare se anëtarët e rinj kanë plotësuar kushtet për anëtarësim.

Traktati i Anëtarësimit

Kur negociatat mbi të gjithë kapitujt të kenë përfunduar në nivel të kënaqshëm për të dyja palët, rezultatet inkorporohen në propozim Traktatin e Anëtarësimit. Nëse fiton përkrahjen e Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit European, Traktati nënshkruhet dhe ratifikohet nga vendi kandidat dhe të gjitha Shtetet Anëtare.

Nga nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit deri në anëtarësim

Pasi që të jetë nënshkruar Traktati i anëtarësimit, vendi kandidat bëhet “Shtet i Miratuar” dhe ka të drejta të shfrytëzojë disa privilegje të kushtëzuara deri sa vendi të njihet si Shtet Anëtar i UE-së. Si shtet i miratuar, vendi mund të komentojë propozim planet e UE-së, komunikimet, rekomandimet ose iniciativat, dhe fiton “statusin e vrojtuesit aktiv” të institucioneve dhe agjencive të UE-së, aty ku ka të drejtë të fjalës por jo edhe të votës. Pas përfundimit të procesit të ratifikimit, Traktati i anëtarësimit hyn në fuqi në datën e planifikuar dhe shteti i ardhur bëhet Shtet Anëtar.



Ndihma për kandidatët që përgatiten për anëtarësim

Progresi i vendit drejt UE-së varet nga suksesi i implementimit të reformave të nevojshme për të plotësuar kriteret e anëtarësimit. UE-ja u siguron përkrahje vendeve që përgatiten për anëtarësim në UE.

Linket zyrtare të vendeve candidate me UE-në mund të vendosen me marrëveshje të ndryshme. Për shembull lidhjet zyrtare të Turqisë me UE-në janë përfshirë në marrëveshjen që fillimisht u nënshkrua në vitin 1963 dhe prej atëherë është azhurnuar vazhdimisht ("Marrëveshja e Ankarasë") dhe në Unionin Doganor, të miratuar në vitin 1995.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor u krijua një proces special në vitin 2000, i cili u quajt Proces i Stabilizimit dhe Asocimit (SAP). Ky proces ndjek tre qëllime: stabilizimin dhe tranzicionin e shpejtë në ekonominë e tregut, përkrahjen e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën e anëtarësimit në UE. Procesi i Stabilizim-Asocimit u ndihmon vendeve të rajonit të ndërtojnë kapacitetet e veta dhe të miratojnë dhe implementojnë standardet europiane. Në kuadër të këtij procesi, Unioni u ofron vendeve të Ballkanit Perëndimor koncesione tregtare, marrëveshje kontraktuese dhe ndihmë financiare dhe ekonomike. Nga viti 1991, UE-ja ka siguruar ndihmë me vlerë 12 miliardë € për Ballkanin Perëndimor, një nga ndihmat më të larta për frymë njeriu në tërë botën.

Vendet candidate shpesh duhet të zbatojnë reforma të rëndësishme që të sigurojnë se rregullat e UE-së jo vetëm që janë miratuar por edhe janë implementuar plotësisht. Mund të nevojitet që të formohen organe të reja, siç është autoriteti



Kroacia

i pavarur i konkurrencës dhe agjencia e standardit ushqimor ose të rristrukturojnë institucionet ekzistuese: demilitarizimi i policisë, përmirësimi i mbikqyrësve të mjedisit dhe sigurisë nukleare, ose dhënia e autonomisë më të madhe për prokurorët në betejën kundër korrupsionit.

Këto reforma zakonisht përfshijnë investime të mëdha në fonde dhe njohuri teknike. UE-ja ofron një varg programe dhe mekanizma plotësuese për të siguruar financa dhe ndihmë teknike në zbatimin e këtyre reformave. I vetëdijshëm për sfidat që prezantojnë reformat për qytetarët në vendet candidate, Unioni Europian gjithashtu përkrah edhe strategjitë e kuptimit më të mirë të procesit të anëtarësimit, duke përfshirë edhe dialogun midis vendeve të UE-së dhe vendeve candidate në nivel të shoqërisë civile: unioneve tregtare, shoqatave të konsumatorëve dhe organizatave të tjera joqeveritare.

Një aspekt i rëndësishëm i ndihmës së UE-së është përforsimi i kapacitetit institucional, ose i ashtuquajturit "ndërtim institucional", me anë të zhvillimit të strukturave ose me trajnimin e personelit përgjegjës për zbatimin e rregullave të Unionit Europian në vendin kandidat. Këshillat mbi implementimin e *acquis*-së shpesh sigurohen përmes marrëveshjeve "Tuining", të cilat realizohen përmes punëtorive afatshkurtëra ose elaborohen me ndihmën e ekspertëve të përkrahur nga Shtetet Anëtare të UE-së.



Turqia

Përgatitja e vendeve për anëtarësim gjithashtu nënkupton modernizimin e infrastrukturës së tyre: ndërtimi i fabrikave për zhdukjen e mbeturinave të ngurta ose përmirësimi i rrjeteve të transportit. Vendet kandidat mund të marrin pjesë në programet e UE-së, si për shembull në sferën e shëndetit publik ose hulumtimit, e gjithashtu mund të fitojnë grante dhe kredi nga institucionet ndërkombëtare financiare. Kjo përvojë mundëson që shtetet kandidat të mësojnë mënyrën e përdorimit të fondeve të cilat do të kenë të drejtën t'i përdorin pas anëtarësimit dhe u ndihmon atyre të njohohen me politikat dhe instrumentet e UE-së.

UE-ja ka themeluar një instrument të ri financiar për të financuar ndihmën ndaj vendeve që janë në rrugë drejt anëtarësimit, duke përfshirë stimuluesit dhe kushtet që garantojnë përdorimin më të mirë të parave të UE-së. Ky instrument i vetëm i pagëzuar "Instrumenti për Ndhimë Para-anëtarësuese" (IPA), që hyri në fuqi më 1 janar 2007, është thjeshtësim i gamës së gjerë të programeve paraprake ndihmëse të UE-së, si PHARE, CARDS ose SAPARD.

IPA do të ndihmojë veçanërisht në përforcimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit, reformën e administratës publike, zbatimin e reformave ekonomike, përkrahjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe barazisë gjinore, përk-

rahjen e zhvillimit të shoqërisë civile, avancimin e bashkëpunimit rajonal dhe kontributin për zhvillim të vazhdueshëm dhe zvogëlimin e varfërisë. Për vendet kandidat, synimi plotësues është miratimi dhe implementimi i plotë i kërkesave të anëtarësimit.

IPA do të sigurojë gjithsej €11,468 milionë me vlerën aktuale, për periudhën 2007–2013, me shpërndarje që do të caktohet vit pas viti.



Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Korniza Treguese Financiare për Instrumentin e Ndhimës Para-Anëtarësuese deri në vitin 2010 (vlerat janë të shprehura në milionë euro dhe në bazë të çmimeve aktuale)				
	2007	2008	2009	2010
Turqia	497.2	538.7	566.4	653.7
Kroacia	138.5	146.0	151.2	154.2
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	58.5	70.2	81.8	92.3
Serbia	186.7	190.9	194.8	198.7
Mali i Zi	31.4	32.6	33.3	34.0
Kosova (nën UNSCR 1244)	68.3	64.7	66.1	67.3
Bosnje e Hercegovina	62.1	74.8	89.1	106.0
Shqipëria	61.0	70.7	81.2	93.2
Gjithsej	1260.2	1383.3	1480.4	1621.7

E ardhmja

Zgjerimet e ardhshme do të përfshijnë vendet e Europës Juglindore. Është në dobi të mbarë Europës të përkrahen transformimet demokratike të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, si dhe të konsolidohet stabiliteti.

Në dhjetor të vitit 2006, Këshilli European ripërtriu konsensusin e vet mbi zgjerimin. UE-ja ka pranuar seriozisht shqetësimet e qytetarëve të vet lidhur me ritmin e zgjerimit. Politika e zgjerimit bazohet në parimin e konsolidimit. Kjo nënkupton se UE-ja respekton premtimet ndaj vendeve që tashmë kanë filluar procesin, por tregon kujdes në marrjen e angazhimeve të reja. Kushtëzime të rrepta zbatohen për të gjitha vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë. Afatet e mundshme të anëtarësimit të tyre varen nga progresi i tyre në reformat politike dhe ekonomike dhe nga pajtimi me ligjet e organeve të UE-së. Çdo vend do të vlerësohet për meritat e veta.



Në mënyrë që zgjerimi të jetë i suksesshëm, përkrahja e qytetarëve është element i domosdoshëm si në Shtetet Anëtare të UE-së ashtu edhe në vendet kandidatë dhe potenciale për kandidatë. Është me rëndësi që të kumtohen sukseset dhe sfidat e zgjerimit, në mënyrë që të fitohet përkrahja e përgjithshme dhe zhvillimi i përbashkët të konsiderohet si projekt i përbashkët.

Anëtarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë në janar të vitit 2007 përmbylli ciklin e pestë të zgjerimit të UE-së, i cili filloi në vitin 2004 dhe shtoi numrin e Shteteve Anëtare prej 15 në 27. Zgjerim i këtillë ose i ngjajshëm nuk është parashikuar për të ardhmen. UE-ja duhet të vazhdojë zgjerimin e vet sipas ritmit që do ta definojnë qytetarët e vet dhe në bazë të progresit të vendeve kandidatë në plotësimin e kërkesave.

Karakteri i Unionit European është dinamik. Gjatë viteve të fundit ka pasur shumë arritje dhe udhëtimi vazhdon. Unioni ka marrë përsipër që të vazhdojë negociatat. Në procesin e integritimit të anëtarëve të rinj, do të punojmë së bashku drejt forcimit të prosperitetit, sigurisë dhe solidaritetit.

UE-ja dhe vendet e involvuara duhet të përfitojnë nga fuqia transformuese e procesit që shpie drejt anëtarësimit.

Historia e procesit

- 1957 Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda nënshkruajtën Traktatin e Romës dhe formuan Komunitetin Europian Ekonomik (EEC).
- 1963 U nënshkrua Marrëveshja e Ankarasë me Turqinë.
- 1973 Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe anëtarësohen në KE.
- 1981 Greqia anëtarësohet në UE.
- 1986 Spanja dhe Portugalia anëtarësohen në KE.
- 1987 Turqia bën kërkesë për anëtarësim në KE.
- 1990 Pas ribashkimit të Gjermanisë, integrohet ish Republika Demokratike e Gjermanisë.
- 1993 Këshilli Europian në Kopenhagë i përcakton kriteret e anëtarësimit.
- 1995 Austria, Finlanda dhe Suedia bashkohen me UE-në. Unioni Doganor me Turqinë.
- 1999 Këshilli Europian në Helsinki miraton statusin e Turqisë si vend kandidat.
- 2000 Samiti në Zagreb konfirmon angazhimin e plotë në Procesin e Stabilizimit dhe Asocimit me vendet e Ballkanit Perëndimor.
- 2003 Kroacia bën kërkesën për anëtarësim në UE. Samiti i Selanikut ripohon angazhimet e UE-së për integrimin përfundimtar të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Union.
- 2004 Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia anëtarësohen në UE. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dorëzon kërkesën për anëtarësim në UE.
- 2005 Fillimi i negociatave me Turqinë dhe Kroacinë. Fillon ekzaminimi i Turqisë dhe Kroacisë.
- 2006 Hapja dhe mbyllja e përkohshme e kapitullit të parë të negociatave me Kroacinë dhe Turqinë.
- 2007 Janar: Bullgaria dhe Rumania anëtarësohen në UE.

Informata të tjera mbi Unionin European



Hapeni internetin

Informatat në të gjitha gjuhët zyrtare të Unionit European mund t'i gjeni në faqen e internetit Europa: europa.eu



Ejani dhe na vizitoni

Në mbarë Europën ka disa qindra qendra informative lokale të UE-së.

Adresën e qendrës më të afërt informative mund ta gjeni në faqen:

europa.eu.int/comm/relays/index_en.htm



Paraqituni ose na shkruani

EUROPE DIRECT është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja mbi Unionin European.

Këtë shërbim mund ta kontaktoni përmes telefonit pa pagesë: 00 800 6 7 8 9 10 11

(telefoni me pagesë në raste të thirrjeve jashtë UE-së: (32-2) 299 96 96),

ose me anë të postës elektronike europedirecteuropa.eu

Informata dhe broshura mbi UE në anglisht, maqedonisht dhe shqip mund të merrni në adresat vijuese:

Qendra informative e

Unionit European

M.H.Jasmin 52v

1000 Shkup

Tel/faks: ++ 389 (0) 2 329 63 6

Internet: www.euic.mk

www.delmkd.ec.europa.eu

E-mail: euinfo@euic.mk

Pika informative e UE në Gostivar

Braça Ginovski 61

1230 Gostivar

Tel 042/218-167 Faks.042/218-167

E-mail: gostivar@euinfopoint.mk

Pika informative e UE në Koçani

Rade Kratoççe 1

2300 Koçani

Tel 033/279-554 Faks.033/279-962

E-mail: kocani@euinfopoint.mk

Pika informative e UE në Kumanovë

11 Oktovri bb

1300 Kumanovë

Tel 031/475-800 Faks.031/475-800

E-mail: kumanovo@euinfopoint.mk

Pika informative e UE në Veles

Panko Brashnar 1

1400 Veles

Tel 043/232-406; lok. 226 Faks. 043/232-966

E-mail: veles@euinfopoint.mk

Pika informative e UE në Kavadarci

Marshal Tito bb

1430 Kavadarci

Tel 043/416-107 Faks.043/416-107

E-mail: kavadarci@euinfopoint.mk

Pika informative e UE në Manastir

1 Maj bb

7000 Manastir

Tel 047/234-234 Faks 047/234-234

E-mail: bitola@euinfopoint.mk

Pika informative e UE në Tetovë

Dervish Cara

1200 Tetovë

Tel 070/548 576

E-mail: tetovo@euinfopoint.mk

EUi – Shkup

Fakulteti Ekonomik

Univerziteti "Shën Kirili dhe Metodi"

Krste Misirkov bb 1000 Shkup

Tel 02/3286-835 Faks.02/31 18-701

Internet: www.eccf.ukim.edu.mk

E-mail: eui-sk@eccf.ukim.edu.mk

EUi – Tetovë

Universiteti i Evropës Juglindore

Ilindenska bb 1200 Tetovë

Tel. 044/356 205 Faks. 044/356 001

E-mail: eui-te@seeu.edu.mk

EUi - Manastir

Fakulteti i Administrimit dhe Menaxhimit të

Sistemeve Informative – Manastir

Partizanska bb 7000 Manastir

Tel 047/259 923 Faks. 047/259 917

E-mail: eui-bt@famis.edu.mk

Përfaqësitë dhe zyrat e Komisionit dhe Parlamentit European ndodhen në të gjitha shtetet e Unionit European. Komisioni European ka Delegacione edhe në pjesë të tjera të botës.

Më tepër informata mbi zgjerimin mund të gjeni në faqen e
Drejtorisë Gjenerale të Komisionit Europian për Zgjerim.

<http://ec.europa.eu/enlargement/>

Komisioni Europian – Drejtoria Gjenerale për Zgjerim
Grupi A2: Informimi dhe Komunikimi
Adresa e zyrës: Rue de la Loi 200, B-1049 Bruksel
Tel: (+32-2) 299.06.66 Fax: (+32-2) 299.17.77



ISBN 978-92-79-06636-8



9 789279 066368